

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të pandehurës M. K., nga fshati K. i U., Komuna e R., për shkak të veprës penale keqpërdorim i së drejtës së votimit, nga neni 216 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Sh. Sh., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.L.nr.131/2014, e datës 12.06.2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 17.06.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë :

AKTGJYKIM

E pandehura M. K., nga babai R. dhe nëna M., e lindur N., e lindur më ..., në fshatin K. i U., Komuna e R., ku edhe jeton, serbe, shtetase e Republikës së Kosovës, e shkukurëzuar, nënë e një fëmiju, pensioniste, e gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, nuk ka qenë e dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTORE

Sepse më datën2013, në Qendrën e Votimit numër ..., në Shtëpinë e Kulturës R., e pandehura me dashje direkte ka keqpërdorur të drejtën e votimit në atë mënyrë që fillimisht voton si votuese e rregullt me rastin e zgjedhjeve lokale të mbajtura në Kosovë, e më pas voton përsëri me kusht, edhe pse e njëjta e ditur se ka votuar një herë duke keqpërdorur të drejtën e ushtrimit të votimit dhe të drejtës elektorale,

- me këtë ka kryer veprën penale keqpërdorim i të drejtës së votimit, nga neni 216 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe në bazë të neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të pandehurës M. K., i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Ashtu që ndaj të pandehurës M. K., i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, të cilin dënim e pandehura nuk do ta mbajë, nëse në afatin prej 1 (një) viti nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet e pandehura që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 12.06.2014 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurës M. K., nga fshati K. i U., Komuna e R., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale keqpërdorim i së drejtës së votimit, nga neni 216 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 17.06.2015 dhe gjatë këtij shqyrtimi fillestar, prokurori i shtetit Agron Uka, e ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit të aktakuzës, e pandehura M. K., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të pandehurës, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë sipas aktakuzës së lartcekur, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e pandehura, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e saj, avokatin Sh. Sh.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se e pandehura M. K., me dashje e ka kryer veprën penale keqpërdorim i së drejtës së votimit, nga neni 216 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 216 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë” dhe për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet. Kryetari i trupit gjykues e ka shpallur fajtor të pandehuren M. K., për shkak të kësaj forme të veprës penale, ngase veprimet e të njejtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjëse. Kjo për faktin se e njejtja, siç e ka pranuar edhe vetë, më datën2013, në Qendrën e Votimit numër ..., në Shtëpinë e Kulturës R., e pandehura me dashje direkte ka keqpërdorur të drejtën e votimit në atë mënyrë që fillimisht voton si votuese e rregullt me rastin e zgjedhjeve lokale të mbajtura në Kosovë, e më pas voton përsëri me kusht, edhe pse e njëjta e ditur se ka votuar një herë.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të pandehurën M. K., ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ndaj të pandehurës, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë :

- se e pandehura e ka pranuar fajësinë;
- faktin se e pandehura para kryetarit të trupit gjykues ka deklaruar se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale;
- se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale;³
- sjelljet shumë të mira të pandehurës gjatë shqyrtimit fillestar;
- se sipas deklaratës së të pandehurës, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, e njëjta është nënë një fëmiju;
- se e njëjta është e shtyrë në moshë;
- se e njëjta është e sëmurë;⁴
- se sipas deklaratës së të pandehurës, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, e njëjta ka gjendje të vështirë materiale dhe nuk realizon të ardhura, përveç pasionit, si dhe
- faktin se e pandehura ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë më ndonjë vepër tjetër penale.

Ndërsa, kryetari i trupit gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

³ Shkresat e referentëve të kësaj Gjykate, të datave 06.05.2015 dhe 13.05.2015.

⁴ Raporti mjekësor, nr.2457, i datës 13.05.2015.

7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurës M. K., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e patur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurës, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nën 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurën ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 Euro.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 17.06.2015

Sekretarja juridike,
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.